

FOL

Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në luftën kundër dhunës në familje gjatë vitit 2022

ANALIZË STATISTIKORE



Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në luftën kundër dhunës në familje gjatë vitit 2022

ANALIZË STATISTIKORE

Titulli: Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në luftën kundër dhunës në familje gjatë vitit 2022 (Analizë Statistikore)

Autore: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Prill 2023

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org +383 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Sundim të Ligjit (INL). *Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Departamentit të Shtetit Amerikan.

Përmbajtja

1. Hyrje	6
2. Metodologjia	8
3. Përmbledhja ekzekutive	9
4. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022	11
4.1 Fluksi i lëndëve.....	16
4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate).....	19
4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio).....	21
4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)	23
4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	25
4.6 Numri i aktakuzave të ngritura (për persona) nga secila prokurori themelore dhe nga ajo speciale	27
5. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022	28
5.1 Fluksi i lëndëve.....	34
5.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate).....	36
5.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio).....	38
5.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)	40
5.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	42
7. Rekomandime	44

1. Hyrje

Dhuna në familje padyshim se përbën një vepër të rëndë ligjore dhe morale e cila doemos do të duhej të merrte përgjigjen më të ashpër nga ana e shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Angazhimi shoqëror në drejtim të mbrojtjes nga këto vepra do të duhej të ishte minimumi jetik në kuptim të ruajtjes dhe ujitjes së vlerave të pastra të shoqërive demokratike dhe bashkëkohore. Veprimet e shoqërisë do të duhej të përktheheshin në normativa ligjore të përshtatshme në luftën gjithëpërfshirëse kundër dhunës në familje.

Ne bazë të hulumtimeve të ndryshme, përkundër nivelit të madh të përhapjes së këtij fenomeni, dhuna në familje është një prej formave më të përhapura të kriminalitetit në shoqërinë kosovare, prandaj krijimi i mekanizmave të rinj dhe forcimi i mekanizmave ekzistues paraqitet si nevojë imanente për luftimin e kësaj dukurie. Kuadri ligjor dhe institucional në këtë fushë është kryesisht në përputhje me atë të Bashkimit Evropian dhe me standardet ndërkombëtare, por sfiduese mbetet çështja e zbatimit të tij.

Përkundër nivelit të përhapjes së këtij fenomeni, dhuna në familje vazhdon të mbetet një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë tonë. Në bazë të raporteve dhe hulumtimeve të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, shumë gra dhunën në familje në Kosovë ende e konsiderojnë si një çështje private, prandaj dhuna me bazë gjinore shpesh kalon pa u vërejtur dhe nuk raportohet fare. Sipas këtyre raporteve, vlerësohet se një në çdo tri gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri, ndërsa një në çdo dhjetë gra ka përjetuar marrëdhënie seksuale të dhunshme ose akte të tjera seksuale të dhunshme në një moment të jetës së tyre.¹

Dhuna në familje parashihet në nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin e fundit të kapitullit XXI të këtij kodi (Veprat penale kundër martesës dhe familjes). Sipas këtyre dispozitave, kushdo që kryen dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cënimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet.² Për më tepër, kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese.

¹ Për më tepër, shih: http://ëëë.kipred.org/repository/docs/Qasja_n%C3%AB_drejt%C3%ABsi_e_viktimave_t%C3%AB_dhun%C3%ABs_me_baz%C3%AB_gjinore_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_P%C3%ABrfundimi_i_mosnd%C3%ABshkimit_t%C3%AB_autor%C3%AB_528871.pdf

² Kodi Nr. 06/l-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 248, para. 1

Duhet theksuar se Kodi i vjetër Penal i Republikës së Kosovës³, i cili tashmë është shfuqizuar, nuk e parashihte dhunën në familje si vepër penale të veçant. Kryesit e këtyre veprave në atë kohë akuzoheshin për vepra të tjera penale të parashikuara në Kodin Penal, në formë të rëndë, si: *Kanosja (neni 185); Ngacmimi (neni 186); Sulmi (neni 187); Lëndimi i lehtë trupor (neni 188); Lëndim i rëndë trupor (neni 189); Privimi i kundërligjshëm i lirisë (neni 196); Tortura (neni 199); Dhunimi (neni 230); Sulmi seksual (neni 232); Degradimi i integritetit seksual (neni 233); Marrëdhëniet seksuale brenda familjes (neni 243); Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 385); Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 388).*

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian për vitin 2022, dhuna në familje vazhdon të jetë forma më e shpikatur e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Sipas këtij raporti, korniza ligjore dhe institucionale në këtë fushë është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe me ato ndërkombëtare. Por, sipas këtij raporti, ndjekja penale dhe gjykimi efektiv i rasteve (përfshirë shqiptimin e dënimit të duhur) mbeten të kufizuara.

Raporti theksoj se gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime pozitive, por që duhet bërë më shumë për të adresuar rekomandimet e dhëna në raportin paraprak. Ndër të tjera, raporti theksoj: “[...] Kosova tregoi përkushtim në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore duke zbatuar më tej Ligjin për Barazi Gjinore në procesin e rekrutimit në administratën publike dhe duke përmirësuar koordinimin ndërinstytucional për luftimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë miratimin e një strategjie dhe plani të ri veprimi kundër dhunës në familje dhe dhunës kundër grave...”.

Sipas Komisionit Evropian, *çështjet e të drejtave themelore duhet të shfaqen më lart në agjendën politike*. Gjithashtu raporti theksoj se nevojiten më shumë përpjekje për të adresuar rekomandimet e raportit të vitit 2021, të cilat janë ende të zbatueshme. Raporti shtoj se: “[...] Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti: *Të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm të koordinimit dhe mbikëqyrjes së legjislacionit, strategjive dhe politikave të të drejtave themelore; të forcohet zbatimi i instrumenteve ekzistuese; të miratohet një sistem funksional i matjes dhe raportimit për zbatimin e Programit të të Drejtave të Njeriut dhe Planit të Veprimit; si dhe të miratohen aktet nënligjore që dalin nga Ligji i ri për Mbrojtjen e Fëmijëve; miratimi i Kodit Civil.*”⁴

³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082 (i shfuqizuar).

⁴ COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, Kosovo* 2022 Report

2. Metodologjia

Ky raport adreson çështjen e performancës dhe efikasitet të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje, si dhe shtjellon nivelin e ngarkesës së punës së këtyre institucioneve në zgjidhjen e këtyre lëndëve.

Raporti është bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për vitin 2022, ndërsa për matjen e performancës së këtyre institucioneve mbi bazën e këtyre statistikave zyrtare, FOL ka përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).⁵

Të gjitha statistikat e paraqitura në këtë raport përfshijnë vetëm një grup të veprave penale, më saktësisht veprat penale të nenit 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht veprat penale të dhunës në familje. Këto statistika përfshijnë vetëm veprat penale me kryerës të njohur (PP).

Efikasiteti i shtatë prokurorive themelore (*Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë*), në njërën anë, dhe i shtatë gjykatave themelore të Kosovës, në anën tjetër, kanë qenë pjesë e matjes së performancës dhe e monitorimit në këtë raport. Kjo matje nuk përfshinë cilësinë e lëndëve dhe të zgjidhjes së tyre, cilësinë e punës së prokurorive dhe gjykatave, cilësinë e shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por vetëm analizën numerike (kuantitative) të zgjidhjes së tyre.

Fushat në të cilat FOL është bazuar për matjen e performancës së prokurorisë dhe gjyqësorit janë si në vijim: 1) fluksi i lëndëve; 2) norma e zgjidhjes së lëndëve; 3) norma e qarkullimit të lëndëve; 4) kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve; si dhe 5) indeksi i lëndëve të grumbulluara.

Në pjesën e parë të raportit është matur performanca e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje përmes indikatorëve të Komisionit Evropian të Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) në nivel të përgjithshëm dhe për secilën prokurori veç e veç.

Ndërsa në pjesën tjetër është analizuar performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje përmes metodologjisë së CEPEJ, po ashtu në nivel të përgjithshëm dhe për secilën gjykatë veç e veç, si dhe numri dhe lloji i vendimeve të shqiptuara nga ana e gjykatave.

Ky është raporti i dytë në lidhje me analizimin statistikor të veprave penale të dhunës në familje përmes metodologjisë së CEPEJ të bërë nga Lëvizja FOL⁶, ndërsa matje të tilla për veprat penale të korrupsionit përmes metodologjisë së CEPEJ, FOL ka bërë edhe në të kaluarën dhe të njëjtën do ta vazhdoj në mënyrë periodike edhe në muajt e ardhshëm.⁷

5 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) është organi i Këshillit të Evropës, i cili përpiket të përmirësojë efikasitetin dhe funksionimin e drejtësisë në shtetet anëtare dhe të zhvillojë dhe zbatojë instrumentet praktike të miratuara nga Këshilli i Evropës për këtë qëllim. Duhet theksuar se raporti i Lëvizjes FOL nuk është i autorizuar nga Këshilli i Evropës dhe se formulat, edhe pse janë identike, nuk janë zyrtare.

6 Përtej Numrave, Performanca e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2021.

7 Për më tepër, shih: Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit 2017; Performanca e Prokurorisë në Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit gjatë vitit 2020; Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në luftën kundër korrupsionit gjatë vitit 2021.

3. Përmbledhja ekzekutive

Matja e performancës së organeve të sistemit të drejtësisë është i domosdoshëm në analizimin e ndërveprimit sistemor dhe funksional, ku përmes të dhënave të paraqitura identifikohen faktorët konkret të funksionimit apo mosfunksionimit strukturor dhe organizues të sistemit të drejtësisë. Me performancë të prokurorive dhe gjykatave nënkuptojmë rezultatet e arritura gjatë procesit të kryerjes së veprimeve dhe detyrave.

Matja e performancës së cilësisë në thelb natyrisht nuk nënkupton vetëm marrjen e shifrave statistikore, mirëpo ajo ka për qëllim vlerësimin objektiv të punës së prokurorive dhe gjykatave në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, vetëm përmes një metodologjie të analizës dhe vlerësimit të vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë mund të gjenden mangësitë që pashmangshëm duhen përmirësuar.

Në bazë të të dhënave që i kemi siguruar dhe projektimit të tyre në bazë të metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), në këtë përmbledhje do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti.

- Norma mesatare e qarkullimit të lëndëve në shtatë prokuroritë themelore gjatë kësaj periudhe ishte 2.25, që është krijuar mbi faktin se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte dukshëm më i madh në raport me lëndët që kanë mbetur të pazgjidhura, e që janë bartur për vitin 2022. Ndërsa norma mesatare e qarkullimit të lëndëve në shtatë gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022 ishte arritur 1.48, meqë numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte më i lartë në raport me numrin e lëndëve që kishin mbetur të pazgjidhura, e që janë bartur në vitin 2022.
- Bartja e numrit të madh të lëndëve nga viti në vit vazhdon të mbetet sfiduese në organet e sistemit të drejtësisë. Në vitin 2022, në shtatë prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës ishin bartur gjithsej 1,372 lëndë të dhunës në familje nga vitet paraprake, apo 44 % të të gjitha lëndëve në punë. Ndërsa në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në vitin 2022 ishin bartur 417 lëndë të dhunës në familje nga vitet paraprake, përkatësisht 26 % e lëndëve që kanë qenë në punë në vitin 2022.
- Norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në shtatë prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës për vitin 2022 rezulton të jetë 101 %, që nënkupton se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte më i lartë se numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit. Ndërsa norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2022 ishte 80 %, që nënkupton se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (961 lëndë) ishte dukshëm më i ulët se numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit (1,191 lëndë).
- Indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara në shtatë prokuroritë themelore gjatë vitit 2022 është arritur në 0.45 dhe ka rrjedhur si pasojë e faktit se numri i lëndëve të dhunës në familje të trashëguara nga viti paraprak (1.372 lëndë) është më i ulët në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti (3,154 lëndë). Ndërsa indeksi i lëndëve të grumbulluara në shtatë gjykatat themelore Kosovës është dukshëm më i ulët, përkatësisht 0.43, për shkak se numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak ishte më i ulët (417 lëndë), se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti (961 lëndë).

- Me fluksin më të madh të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 është përballur Prokuroria Themelore e Prishtinës, e cila në punë ka pasur 1,877 lëndë. Ndërkaq prokuroria me fluksin më të ulët të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 ka qenë Prokuroria Themelore e Gjilanit, e cila në punë ka pasur gjithsej 244 lëndë të dhunës në familje. Ndërsa edhe në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, me fluksin më të madh të lëndëve të dhunës në familje është përballur Gjykata Themelore e Prishtinës, me 717 lëndë në punë, ndërsa me fluksin më të ulët të këtyre lëndëve është përballur Gjykata Themelore e Ferizajt, me gjithsej 70 lëndë të dhunës në familje në punë.
- Sipas statistikave të përgjithshme të siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), prokuroria që ka arritur rezultatet më të mira në zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje gjatë kësaj periudhe është Prokuroria Themelore e Gjilanit e cila gjatë kësaj periudhe ka arritur normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve (243), indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara (0.02), kohën më të shkurtë të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura (2 ditë). Me fjalë të tjera, nga 244 lëndë të dhunës në familje sa ka pasur në punë kjo prokurori, ka arritur të zgjidh 243 lëndë, apo 99.5 % të të gjitha lëndëve të dhunës në familje që i ka pasur në punë gjatë vitit 2022 dhe vetëm 1 lëndë e ka bartur për vitin 2023.
- Ndërkaq prokuroria me rezultatet më të dobëta në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 ishte Prokuroria Themelore e Prishtinës, e cila nga 1,877 lëndë sa ka pasur në punë gjatë vitit 2022, ka arritur të zgjidh vetëm 1,042 prej tyre, apo 56 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë. Kjo prokurori gjatë kësaj periudhe ka arritur indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara (0.95), si dhe kohën më të gjatë të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura (294 ditë).
- Ndërsa sipas të dhënave të përgjithshme të siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), rezultatet më të mira në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 i ka arritur, po ashtu, Gjykata Themelore e Gjilanit, e cila gjatë kësaj periudhe e ka arritur indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara (0.06), si dhe kohën më të shkurtë për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (125 ditë). Me fjalë të tjera, nga 153 lëndë të dhunës në familje sa ka pasur në punë kjo gjykatë, ka arritur të zgjidh 116 lëndë, apo 74 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë gjatë vitit 2022.
- Ndërkaq gjykata me rezultatet më të dobëta në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje ishte Gjykata Themelore e Ferizajt, e cila gjatë kësaj periudhe ka pasur 70 lëndë në punë dhe ka arritur të zgjidh vetëm 35 prej tyre, apo vetëm 50 % të lëndëve në punë. Kjo gjykatë ka arritur normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve (61%), si dhe kohën më të gjatë të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (365 ditë).

4. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022

Performanca e mirë e prokurorive në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje, pra efikasiteti në ndjekjen e personave të involvuar në këto vepra penale, nënkupton respektimin e plotë të ligjeve dhe prioriteteve të vendosura nga ana e Këshillit Prokurorial.



4. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022

Analiza e performancës së punës së sistemit prokurorial në trajtimin e rasteve nga dhuna në familje është veprim i domosdoshëm në kuptim të vlerësimit të përpjekjeve institucionale dhe pritjes së rezultateve në luftimin e kësaj dukuri. Arritja e një niveli të kënaqshëm të vëllimit të veprimeve institucionale në parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni, padyshim se më së miri përkthehet dhe shihet në rezultatet statistikore dhe empirike të punës së institucioneve brenda sistemit prokurorial.

Duke i analizuar përparësitë dhe shpërfaqur dobësitë në punën e prokurorive gjatë trajtimit të lëndëve të dhunës në familje, do të mund të kontribuojmë në pasqyrimin e situatës së përgjithshme të luftimit të këtij fenomeni. Performanca e mirë e prokurorive në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje, pra efikasiteti në ndjekjen e personave të involvuar në këto vepra penale, nënkupton respektimin e plotë të ligjeve dhe prioriteteve të vendosura nga ana e Këshillit Prokurorial.

Në vijim të raportit janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së shtatë prokurorive themelore në përgjithësi në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022. Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit prokurorial, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.








	PS Lëndë të trashëguara	I Lëndë të reja	LP Gjithsej lëndë në punë	R Lëndë të zgjidhura	PE Lëndë të pazgjidhura
 Prokuroria Themelore në Prishtinë	991	886	1,877	1,042	835
 Prokuroria Themelore në Gjiilan	5	239	244	243	1
 Prokuroria Themelore në Prizren	11	344	355	331	24
 Prokuroria Themelore në Mitrovicë	151	235	386	250	136
 Prokuroria Themelore në Gjakovë	95	271	366	254	112
 Prokuroria Themelore në Pejë	113	730	843	640	203
 Prokuroria Themelore në Ferizaj	6	269	275	252	23
TOTAL:	1,372	2,974	4,346	3,012	1,334

TABELA 1. Pasqyra e përgjithshme e performancës së sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022.

4.1 Fluksi i lëndëve

Një prej vështirësive më të mëdha në menaxhimin sa më efikas dhe cilësor të lëndëve nga ana e prokurorive është fluksi i madh i lëndëve. Pra, fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja, lëndët e zgjidhura dhe lëndët në pritje të zgjidhjes.

Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë veprim nga prokurorët, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjja që jep sistemi prokurorial, pra numri i lëndëve që janë trajtuar.⁸

Ndërkaq lëndët që priten të trajtohen janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga prokuroria në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten në vitin e ardhshëm. Në analizë nuk është përfshirë faza fillestare, pra faza e hetimit apo e mbledhjes së informatave para se ato të kthehen në kallëzime penale. Në raport pra janë përfshirë vetëm kallëzimet penale të dërguara në prokurori dhe adresimi i tyre nga ana e sistemit prokurorial.

Fluksi i lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese) + I (lëndë të reja)

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, gjithsej raste në punë në shtatë prokuroritë themelore në lidhje me veprat penale të *dhunës në familje* kanë qenë **4,346 lëndë**.

Në këtë numër, pra, kanë kontribuar lëndët e bartura nga viti paraprak (1,372 lëndë), si dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit (2,974 lëndë). Pra, shprehur në përqindje, mesatarisht 32 % e lëndëve të *dhunës në familje* në punë të shtatë prokurorive ishin të bartura nga vitet paraprake, ndërsa 68 % e lëndëve ishin lëndë të reja, të krijuar gjatë vitit 2022.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur fluksi i lëndëve të shtatë prokurorive themelore veç e veç gjatë vitit 2022.

⁸ Trajtimi dhe zgjidhja mund të shërbejnë si fjalë që zëvendësojnë njëra-tjetrën. Për gjykata përdoret fjala "zgjidh" kurse për prokurori "trajton". Kjo pasi lënda në prokurori nuk konsiderohet e zgjidhur pa një vendim të gjykatës.

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)



Prokuroria
Themelore e
Prishtinës



1,877

= 991+886



Prokuroria
Themelore e Gjilanit



244

= 5 + 239



Prokuroria
Themelore
e Prizrenit



355

= 11 + 344



Prokuroria
Themelore
e Mitrovicës



386

= 151 + 235



Prokuroria
Themelore
e Gjakovës



366

= 95 + 271



Prokuroria
Themelore
e Pejës



843

= 113 + 730



Prokuroria
Themelore
e Ferizajt



279

= 6 + 269

TOTAL:

4,346

= 1,372 + 2,974

TABELA 2. Fluksi i lëndëve të dhunës në familje në shtatë prokuroritë themelore gjatë vitit 2022.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se me fluksin më të lartë të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 është përballur:

- Me fluksin më të lartë të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022:
 1. *Prokuroria Themelore e Prishtinës (1,877 lëndë);*
 2. *Prokuroria Themelore e Pejës (730 lëndë);*
 3. *Prokuroria Themelore e Mitrovicës (386 lëndë).*

- Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të dhunës në familje është përballur:
 1. *Prokuroria Themelore e Gjilanit (244 lëndë);*
 2. *Prokuroria Themelore e Ferizajt (275 lëndë);*
 3. *Prokuroria Themelore e Prizrenit (355 lëndë).*

4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që mat raportin midis numrit të lëndëve të reja (I) dhe numrit të lëndëve të zgjidhura (R).

Pra në kuadër të matjes, në këtë indikator nuk përfshihen numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak. Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një prokurorie të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të prokurorive në zgjidhjen e lëndëve të reja. Norma ideale e zgjidhjes së lëndëve do të duhej të ishte 100%, që nënkupton se sistemi zgjidh aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

Norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore është si vijon:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{3,012}{2,974} \times 100 = 101 \%$$

Pra sipas kësaj formule, numri i lëndëve të dhunës në familje të zgjidhura gjatë vitit 2022 ishte 3,012, numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2022 ishte 2,974, norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 del të jetë 101 %.

Pra numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2022 ishte ndjeshëm më i ulët në raport me lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti.

Me fjalë të tjera, nga 4,346 lëndë të dhunës në familje që ishin në punë gjatë vitit 2022 (këtu përfshihen lëndët e trashëguara nga vitet paraprake dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit), prokuroritë kanë arritur të zgjedhin 3,010 lëndë, ndërsa pjesa tjetër prej 1,336 lëndësh kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2023.

Ndërkaq norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në secilën prokurori themelore gjatë vitit 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura brenda një viti. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Formula e Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë përdor numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe e pjesëton me numrin e lëndëve të pazgjidhura, duke nxjerrë normën e qarkullimit të lëndëve.

Me falë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma e qarkullimit të lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$

Rrjedhimisht nga kjo formulë, norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në të gjitha prokuroritë themelore gjatë vitit 2022 është:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{3,012}{1,334} = 2.25$$

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm. Ndërsa, në këtë rast norma e qarkullimit të lëndëve është pak më e madhe se 1, që nënkupton se në rastin konkret ka diferencë të vogël në raport me normën ideale të qarkullimit të lëndëve.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 në secilën prej shtatë prokurorive themelore është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$



Prokuroria Themelore në
Prishtinë

$$\frac{1042}{835} = 1.24 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Gjilan

$$\frac{243}{1} = 243 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Prizren

$$\frac{331}{24} = 13.70 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Mitrovicë

$$\frac{250}{136} = 1.83 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Gjakovë

$$\frac{254}{112} = 2.26 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Pejë

$$\frac{640}{203} = 3.15 \rightarrow$$



Prokuroria Themelore në
Ferizaj

$$\frac{252}{23} = 10.95 \rightarrow$$

TOTAL:

$$\frac{3,012}{1,334} = 2.25 \rightarrow$$

TABELA 4. Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezultojnë se normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022 e ka arritur:

- Prokuroria Themelore në Gjilan (243)

Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve e ka arritur:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë (1.24).

4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve, që kalkullohet në dy hapa.

Së pari, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese pjesëtohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, që njihet si normë e qarkullimit të lëndëve.⁹

Së dyti, kjo normë e qarkullimit të lëndës pjesëtohet me 365, kështu që indikator i kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjedhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që priten të zgjidhen (lëndët e bartura).¹⁰

Bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve, kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Pra numri 365 është numri i ditëve brenda një viti, i cili pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë prokurorive themelore për vitin 2022.

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve që gjatë vitit 2022 kishin mbetur të pazgjidhura në secilën prokurori themelore veç e veç është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

⁹

¹⁰ Po aty.















		365	
		<i>norma e qarkullimit të lëndëve</i>	
		Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve =	
	Prokuroria Themelore në Prishtinë	$\frac{365}{1.24} =$	294 
	Prokuroria Themelore në Gjilan	$\frac{365}{243} =$	2 
	Prokuroria Themelore në Prizren	$\frac{365}{13.70} =$	26 
	Prokuroria Themelore në Mitrovicë	$\frac{365}{1.83} =$	199 
	Prokuroria Themelore në Gjakovë	$\frac{365}{2.26} =$	162 
	Prokuroria Themelore në Pejë	$\frac{365}{3.15} =$	115 
	Prokuroria Themelore në Ferizaj	$\frac{365}{10.95} =$	33 

TABELA 5.

Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve që nuk janë zgjidhur gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje që në këtë viti kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

- Prokurorisë Themelore të Gjilanit (2 ditë);

Ndërsa kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje i duhet:

- Prokurorisë Themelore të Prishtinës (294 ditë).

4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Prokuroritë, ashtu sikurse gjykatat, vazhdojnë të përballen me lëndë të vjetra që bëhen barrë e ngarkesë e rëndë, e që barten vit pas viti.

Zgjatja e trajtimit të lëndëve dhe numri i madh i lëndëve të bartura bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë, pasi ata duhet të presin me vite të tëra që sistemi të merret me lëndët e tyre dhe të ndaj drejtësi për to.

Pra indikator kyç i performancës së prokurorive është edhe indeksi i lëndëve të grumbulluara. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi i lëndëve të grumbulluara të shtatë prokurorive themelore është:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{1,372}{3,012} = 0.45$$

Nëse në këtë rast do të zgjidheshin 1,372 lëndë, nënkupton se sistemi ka zgjidhur aq lëndë sa ka trashëguar, dhe si e tillë vlera do të ishte 0. Ndërsa në rastin konkret nënkuptohet se prokuroria ka zgjidhur dukshëm më shumë lëndë se sa ka trashëguar nga viti paraprak.

Indeksi i lëndëve të dhunës në familje të grumbulluara në shtatë prokuroritë themelore është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Indeksi i lëndëve të grumbulluara = $\frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$
















	Prokuroria Themelore në Prishtinë	$\frac{991}{1,042}$	= 0.95	
	Prokuroria Themelore në Gjilan	$\frac{5}{243}$	= 0.02	
	Prokuroria Themelore në Prizren	$\frac{11}{331}$	= 0.03	
	Prokuroria Themelore në Mitrovicë	$\frac{151}{250}$	= 0.60	
	Prokuroria Themelore në Gjakovë	$\frac{95}{254}$	= 0.37	
	Prokuroria Themelore në Pejë	$\frac{113}{640}$	= 0.17	
	Prokuroria Themelore në Ferizaj	$\frac{6}{252}$	= 0.02	
TOTAL:		$\frac{1,372}{3,012}$	= 0.45	

TABELA 6.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezultojnë se indeksi më i lartë i lëndëve të grumbulluara e ka arritur:

- Prokuroria Themelore e Prishtinës (0.95);

Ndërsa indeksi më i ulët i lëndëve të grumbulluara:

- Prokuroria Themelore e Gjilanit dhe e Ferizajt (0.02).

4.6 Numri i aktakuzave të ngritura për persona lidhje me rastet e dhunës në familje gjatë vitit 2022

Sipas të dhënave të pranura nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, shtatë prokuroritë themelore gjatë vitit 2022 kanë ngritur aktakuza për gjithsej 1659 persona të përfshirë në lidhje me veprat penale të dhunës në familje.

Numri më i madh i aktakuzave për persona të ngritura gjatë vitit 2022 ishin nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, përkatësisht 510 persona, duke u pasuar nga Prokuroria Themelore e Pejës, përkatësisht me me 525 aktakuza për persona.

Numri i aktakuzave të ngritura në lidhje me veprat penale të dhunës në familje (për persona) nga secila prokurori themelore gjatë vitit 2022, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Numri i aktakuzave për persona




TABELA 7.

Numri i aktakuzave për persona të ngritura gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore.

5. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022

5. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022

Gjykatat e Republikës së Kosovës janë autoriteti kryesor i zingjirit institucional të luftës shtetërore në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje. Rezultatet nga puna e gjykatave do të mund të shpërfaqeshin nga të dhënat sistematike, që nga pranimi i rasteve e deri te zgjidhja meritore e tyre. Këto të dhëna do të duhej të përpunoheshin në pajtim me metodologjinë adekuate, në mënyrë që të krijojmë pasqyra e përgjithshme e përbushjes së misionit të sistemit gjyqësor mbi këtë fushë specifike. Rezultati i rrjedhur nga një përpunim i tillë do të jetë tregues i qartë i normës së zgjidhjes së lëndëve dhe indikatorëve të tjerë sa i përket fushës së dhunës në familje.

Në vijim të raportit janë paraqitur rezultatet nga indikatorët matës të efikasitetit të punës së Gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022, sipas metodologjisë së *Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ)*.

Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit gjyqësor të vitit 2022, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.








	PS Lëndë të trashëguara	I Lëndë të reja	LP Gjithsej lëndë në punë	R Lëndë të zgjidhura	PE Lëndë të pazgjidhura
 Gjykata Themelore në Prishtinë	221	496	717	398	319
 Gjykata Themelore në Gjilan	8	148	156	116	40
 Gjykata Themelore në Prizren	33	137	170	116	54
 Gjykata Themelore në Mitrovicë	11	73	84	61	23
 Gjykata Themelore në Gjakovë	31	93	124	83	41
 Gjykata Themelore në Pejë	100	187	287	152	135
 Gjykata Themelore në Ferizaj	13	57	70	35	35
TOTAL: 417	1,191	1,608	961	647	

TABELA 8. Pasqyra e përgjithshme e performancës së sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022.

5.1 Fluksi i lëndëve

Siç është shtjelluar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, fluksi i lëndëve është tregues i ngarkesës së sistemit më lëndë në punë dhe përfshin lëndët e reja të krijuara gjatë vitit dhe lëndët trashëguara, respektivisht të bartura nga viti paraprak.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur fluksi i lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)



Gjykata Themelore
në Prishtinë



Gjykata Themelore
në Gjilan



Gjykata Themelore
në Prizren



Gjykata Themelore
në Mitrovicë



Gjykata Themelore
në Gjakovë



Gjykata Themelore
në Pejë



Gjykata Themelore
në Ferizaj



TOTAL:

PS	417
LP	1,191
Total	1,608

TABELA 9. Fluksi i lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të republikës së Kosovës gjatë vitit

Nga kjo tabelë shihet se Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 1,608 lëndë të dhunës në familje. Në krijimin e këtyre lëndëve kanë kontribuar lëndët e trashëguara nga viti 2021, përkatësisht **417** lëndë, si dhe numri i lëndëve të krijuara gjatë vitit 2022, përkatësisht 1,191 lëndë.

Pra, shprehur në përqindje, mesatarisht 26 % e lëndëve të dhunës në familje të të gjitha gjykatave ishin të bartura nga viti paraprak, ndërsa 74 % e lëndëve ishin lëndë të reja të krijuar gjatë vitit 2022.

Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja, lëndët e trashëguara, lëndët zgjidhura dhe lëndët në pritje të zgjidhjes.

- Me fluksin më të lartë të lëndëve të dhunës në familje gjatë vitit 2022 është përballur:
 1. *Gjykata Themelore në Prishtinë (717 lëndë)*
 2. *Gjykata Themelore në Pejë (287 lëndë)*
 3. *Gjykata Themelore në Prizren (170 lëndë)*

- Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të dhunës në familje është përballur:
 1. *Gjykata Themelore në Ferizaj (70 lëndë)*
 2. *Gjykata Themelore në Mitrovicë (84 lëndë)*
 3. *Gjykata Themelore në Gjakovë (124 lëndë).*

5.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Siç është theksuar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e sistemit në zgjidhjen e lëndëve të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të sistemit përkatës.

Në normën e zgjidhjes së lëndëve nuk përfshihet numri i lëndëve të trashëguara, por vetëm numri i lëndëve të reja, të krijuara gjatë vitit.

Ashtu siç u shpjegua në pjesën e parë, norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve} = \frac{961}{1,191} \times 100 = 81 \%$$

Sipas kësaj formule, ku numri i lëndëve të dhunës në familje të zgjidhura gjatë vitit 2022 ishte 961 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit ishte 1,191 lëndë, norma e lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2022 ishte 81%. Pra shkalla e parë e sistemit gjyqësor në vitin 2022 ka arritur të zgjidh 230 lëndë më pak se sa ka pranuar në vitin 2022, prandaj kjo është reflektuar edhe në këtë normë të ulët të zgjidhjes së lëndëve.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$



Gjykata Themelore në
Prishtinë

$$\frac{398}{496} \times 100 = 80\%$$



Gjykata Themelore në
Gjilan

$$\frac{116}{148} \times 100 = 78\%$$



Gjykata Themelore në
Prizren

$$\frac{116}{137} \times 100 = 85\%$$



Gjykata Themelore në
Mitrovicë

$$\frac{61}{73} \times 100 = 84\%$$



Gjykata Themelore në
Gjakovë

$$\frac{83}{93} \times 100 = 89\%$$



Gjykata Themelore në
Pejë

$$\frac{152}{187} \times 100 = 81\%$$



Gjykata Themelore në
Ferizaj

$$\frac{35}{57} \times 100 = 61\%$$

TOTAL:

$$\frac{961}{1,191} \times 100 = 80\%$$

TABELA 9.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

Nga kjo tabelë shihet se normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022 e ka arritur:

- Gjykata Themelore në Gjakovë (89 %);

Ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve e ka arritur:

- Gjykata Themelore në Ferizaj (61 %).

5.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Me fjalë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast sistemi gjyqësor) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma e qarkullimit të lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pazgjidhura (PE)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{961}{647} = 1.48$$

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.

Ndërsa në rastin konkret, sistemi gjyqësor ka arritur të zgjidh 961 lëndë nga 1,608 lëndë të cilat i kanë pasur në punë. Ndërkaq 647 lëndë të dhunës në familje, apo 40 % të lëndëve, nuk ka arritur t'i zgjidh dhe i ka bartur për vitin 2023.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$
















	Gjykata Themelore në Prishtinë	$\frac{398}{319} = 1.24$	
	Gjykata Themelore në Gjilan	$\frac{116}{40} = 1.07$	
	Gjykata Themelore në Prizren	$\frac{116}{54} = 1.15$	
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	$\frac{61}{23} = 0.25$	
	Gjykata Themelore në Gjakovë	$\frac{83}{41} = 0.87$	
	Gjykata Themelore në Pejë	$\frac{152}{135} = 0.54$	
	Gjykata Themelore në Ferizaj	$\frac{35}{35} = 0.76$	
TOTAL:		$\frac{961}{647} = 1.48$	

TABELA 10 Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022

Nga kjo tabelë, shihet se normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në vitin 2022 e ka arritur:

- Gjykata Themelore e Mitrovicës (2.65)

Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve e ka arritur:

- Gjykata Themelore e Ferizajt (1).

5.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Pra, siç është shtjelluar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, numri 365 është numri i ditëve brenda periudhës raportuese, që pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë gjykatave themelore, që e kanë arritur në vitin 2022.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$



Gjykata Themelore
në Prishtinë

$$\frac{365}{1.24} = \mathbf{294}$$




Gjykata Themelore
në Gjilan

$$\frac{365}{2.9} = \mathbf{125}$$



Gjykata Themelore
në Prizren

$$\frac{365}{2.14} = \mathbf{170}$$



Gjykata Themelore
në Mitrovicë

$$\frac{365}{2.65} = \mathbf{137}$$



Gjykata Themelore
në Gjakovë

$$\frac{365}{1.62} = \mathbf{225}$$



Gjykata Themelore
në Pejë

$$\frac{365}{1.12} = \mathbf{325}$$



Gjykata Themelore
në Ferizaj

$$\frac{365}{1} = \mathbf{365}$$



TABELA 11.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022. së Kosovës gjatë vitit 2021.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje që në këtë viti kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

- Gjykata Themelore e Ferizajt (365 ditë).

Ndërsa kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje i duhen:

- Gjykatës Themelore e Gjilanit (125 ditë);

5.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është krijimi i numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Këto lëndë barten nga viti në vit, duke krijuar ngarkesë të papërballeshme për sistemin e drejtësisë.

Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese (lëndët e trashëguara), në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2022 është:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{417}{961} = 0.43$$

Në rastin konkret, numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak ishte dukshëm më i ulët se sa numri i lëndëve që ka mundur të zgjidh sistemi gjatë këtij viti, prandaj është reflektuar në indeksin e ulët të lëndëve të grumbulluara.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur indeksi mesatar i lëndëve të dhunës në familje të grumbulluara në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$
















	Gjykata Themelore në Prishtinë	$\frac{221}{398} = 0.6$	
	Gjykata Themelore në Gjilan	$\frac{8}{116} = 0.06$	
	Gjykata Themelore në Prizren	$\frac{33}{116} = 0.28$	
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	$\frac{11}{61} = 0.18$	
	Gjykata Themelore në Gjakovë	$\frac{31}{83} = 0.37$	
	Gjykata Themelore në Pejë	$\frac{100}{152} = 0.65$	
	Gjykata Themelore në Ferizaj	$\frac{13}{35} = 0.37$	
	TOTAL	$\frac{417}{961} = 0.43$	

TABELA 12. Indeksi i lëndëve të grumbulluara në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

Pra, në përgjithësi të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës kanë arritur indeks të ulët të lëndëve të grumbulluara për dhunë në familje, për shkak se ky indikatorë merr për bazë numrin e lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake, dhe jo edhe numrin e lëndëve të reja, të pranuar gjatë vitit.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2022 e ka arritur:

- Gjykata Themelore e Gjilanit (0.06)

Ndërsa indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara, e ka arritur:

- Gjykata Themelore e Pejës (0.65).

Rekomandime

Duke bërë ndërlidhjen në mes të konkluzioneve të këtij raporti dhe intencës për ngritje të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit dhe të sistemit gjyqësor, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- Të krijohet një njësi e veçantë në prokuroritë tjera themelore që merren me rastet e dhunës në familje, njësoj sikurse Njësi për Dhunë në Familje në Prokurorinë Themelore të Prishtinës;
- Të trajtohen me prioritet absolut rastet e dhunës në familje nga ana e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, si dhe të ashpërsohen dënimet ndaj kryerësve të këtyre veprave penale;
- Të intensifikohet bashkëpunimi i Ministrisë së Drejtësisë/Zyrës së Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje me institucionet tjera përkatëse (me qëllim të forcimit të përpjekjeve për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje);
- Të ofrohet siguri e mjaftueshme nga institucionet e sigurisë për mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së viktimave të dhunës në familje;
- Të nxitet rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të të gjithë qytetarëve për reduktimin e dhunës në familje.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë të sigurojnë kushte (salla operative, byzylykë elektronike, trajnime të specializuara) për zbatimin e *Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës*.

FOL

